


KËSHILLIMORJA MJEKO-LIGJORE PËR TË RRITURIT VIKTIMA TË DHUNËS



Hôpitaux
Universitaires
Genève



REPUBLIQUE
ET CANTON
DE GENÈVE

Për çfarë është fjala ?

Këshillimorja e Njesisë mjekësore të dhunës (UMV) është e hapur për çdo njeri të rritur që është viktimë e dhunës të ushtruar brenda çiftit, në familje apo në bashkësi (në hapësirën publike apo në vendin e punës, për shembull).

Shërbimet e saj sigurohen nga një skuadër infermierësh të formuar në mënyrë të posaçme, që punojnë në bashkëpunim të ngushtë me mjekët ligjorë.

Ky këshillim është konfidencial dhe falas.

Çfarë ofron ajo ?

Këshillimorja u siguron viktimave:

- ▶ një pritje dhe dëgjim të vëmendshëm duke u dhënë kështu mundësinë që të flasin për ngjarjet e dhunshme me të cilat janë përballur.
- ▶ një vizitë klinike të përqendruar te dhuna e përjetuar, e cila mundëson përpilimin e dokumentacionit mjekësor ligjor (konstatimin e goditjeve dhe lëndimeve, fotografitë e dëmtimeve). Konstatimi mund ta ndihmojë viktimën në kërkimin e të drejtave të veta.
- ▶ orientimin në gjirin e rrjetit të institucioneve dhe të shoqatave partnere.

Si të merrni takim ?

Duke telefonuar në  022 372 15 00

- ▶ Nga e hëna deri të premten nga ora 08:00 deri në orën 12:00 dhe nga ora 14:00 deri në orën 16:00,
- ▶ Ifundjavave dhe festave publike nga ora 08:00 deri në orën 12:00.

Plani i qasjes

Këshillimorja mjeko-ligjore për të rriturit viktima të dhunës

Rue Jean-Violette 29
1205 Genève

